



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1879/ 6 prot.

Datë 06.08.2025

V E N D I M
Nr. 1017/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 06.08.2025 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Kappa Oil” SHA në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-46805-05-02-2025, me objekt: Loti 2 “*Blerje bateri për automjete*”, me fond limit 39,522,590.84 (*tridhjetë e nëntë milionë e pesëqind e njëzet e dy mijë e pesëqind e nëntëdhjetë pikë tetëdhjetë e katër*) lekë pa TVSH dhe 401,203.85 (*katërqind e një mijë e dyqind e tre*) euro pa TVSH, zhvilluar më datë 04.06.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “*Alket Kopaçi*” PF, me NIPT K41510041C, me adresë Rruga “Kavajës”, Pallati Nr. 102, Shkalla. 1, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
Adresa: Rruga “Reshit Collaku”, Godina Nr.6/337, (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë.
- Subjekt i Interesuar:** Operatori ekonomik “Kappa Oil” SHA me NIPT J91402501L, me adresë: Zona Kadastrale 2547, Nr. Pasurie 159/182, Vol. 19, Fq. 219, Xhafzotaj, Durrës.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë

13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 05.05.2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-46805-05-02-2025, me objekt: Loti 2 “Blerje bateri për automjete”, me fond limit 39,522,590.84 (tridhjetë e nëntë milionë e pesëqind e njëzet e dy mijë e pesëqind e nëntëdhjetë pikë tetëdhjetë e katër) lekë pa TVSH dhe 401,203.85 (katërqind e një mijë e dyqind e tre) euro pa TVSH, zhvilluar më datë 04.06.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 04.06.2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor dhe sistemit të prokurimeve elektronike rezulton se në datën 01.07.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Vëllezërit Agalliu 20” SHA	1,204,000	lekë skualifikuar
2. “Kappa Oil” SHA	19,913,600	lekë kualifikuar
3. “Alket Kopaçi” PF	24,052,100	lekë kualifikuar
4. “AutoAsja” SHA	25,499,600	lekë skualifikuar
5. “Degert Auto” SHA	30,873,420	lekë skualifikuar

II.4. Në datën 01.07.2025, operatori ekonomik “*Alket Kopaçi*” PF është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe kualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi.

II.5. Në datën 08.07.2025 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit paraprak të fituesit në SPE për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.6. Në datën 15.07.2025 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me nr. elektronik A/2025/5557 dhe me numër 1879/2025 prot., datë 15.07.2025 e operatorit ekonomik “*Alket Kopaçi*” PF, nëpërmjet së cilës kundërshton vendimin e komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “*Kappa Oil*” SHA në këtë procedurë prokurimi me argumentat si më poshtë vijon:

Operatori Ekonomik ankues “Alked Kopac” ka marrë pjesë në këtë procedurë dhe është renditur në vendin e dytë pas OE “Kappa Oil”, i cili është shpallur fitues me ofertën më të ulët.

Në bazë të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 98 dhe 99, si dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, paraqesim këto pretendime dhe kërkojmë verifikimin e mëposhtëm për operatorin ekonomik fitues:

Mungesa e autorizimit të prodhuesit sipas dokumenteve të procedurës dhe në përputhje me nenin 61 të ligjit për dokumentacionin e kualifikimit teknik, kërkohet që OE të provojë aftësinë teknike për ofrimin e mallrave. Në këtë procedurë, kemi bindjen, duke marrë shkas nga procedura të mëparshme, se operatori ekonomik “Kappa Oil” nuk ka paraqitur këtë autorizim, ose kanë paraqitur një autorizim të vjetër, me referencë të një procedure të mëparshme për një autoritet kontraktor tjetër. Kjo është në kundërshtim të plotë me kërkesat e dokumenteve standarde të tenderit dhe rregullave të prokurimit publik. Mungesa e autorizimit të prodhuesit përbën shkak për skualifikim pasi nuk provohet lidhja e drejtpërdrejtë ose autorizimi për të tregtuar markat specifike. Pranimi i ofertave pa këtë dokument përbën një shkelje të parimit të barazisë ndërmjet operatorëve ekonomikë, si dhe cenon ligshmërinë e vlerësimit të ofertave.

Mungesa e katalogëve dhe dyshime për vërtetësinë e dokumentacionit teknik dokumentacioni i tenderit ka përcaktuar qartë se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin katalogë teknikë origjinalë të pajisjeve ose produkteve të ofruara, të cilët të përputhen me specifikimet teknike të dhëna nga autoriteti kontraktor. Këta katalogë shërbejnë për të verifikuar karakteristikat teknike të ofertës dhe për të vlerësuar përputhshmërinë me kërkesat e tenderit. Operatori ekonomik “Kappa Oil” nuk ka paraqitur katalogët për bateritë e ofertuara për zërat me nr. Rendor 15, 19, 31, 33, 49, 50, 51, 52, 54, 55, specifikisht për zërat nr. 54 dhe 55, bateritë NATO ku ka dhe mungesë të eksperiencës së mëparshme me këto bateri. Kjo mungesë hap dyshime për falsifikim të katalogëve, në kundërshtim me nenin 98 pika 3 të Ligjit Për Prokurimin Publik, ku ndalohet dorëzimi i dokumentacionit të pavërtetë.

Mospërmbyshja e vlerës së kontratave të ngjashme kriter ekonomik gjithashtu mendojmë dhe kërkojmë nga ana juaj verifikimin e kontratave të ngjashme të paraqitura nga OE “Kappa Oil”, nëse ato i përkasin realisht objektit të procedurës (blerje baterish), nëse përputhen me vlerën dhe karakteristikat teknike të kërkuara.

Duke marrë parasysh sa më sipër, kërkojmë nga autoriteti kontraktor:

- 1. Rishikimin e procesit të vlerësimit të ofertave dhe verifikimin me përpikmëri të dokumentacionit të paraqitur nga operatorët ekonomikë për autorizimet, katalogët teknikë dhe kontratat e ngjashme.*
- 2. Skualifikimin e cdo operatori ekonomik që nuk ka përmbushur kriteret e detyrueshme, përfshirë mungesën e autorizimit të prodhuesit ose mungesën/pasaktësinë e katalogëve.*
- 3. Zbatimin e parimit të barazisë dhe transparencës, si dhe të garantohet integriteti i procedurës në përputhje me Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.*

II.7. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 1879/1 prot., datë 16.07.2025, me kriteret të cilat ankimuesi pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Kappa Oil” SHA të cilat kundërshtohen me anë të ankesës me nr. 1879/2025 prot, datë 16.07.2025.

II.8. Nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike autoriteti kontraktor ka dërguar shkresën nr. 1393/18 prot, datë 22.07.2025 me objekt “Mbi shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik Alked Kopaçi PF lidhur me vlerësimin në procedurën e prokurimit me nr REF-46805-05-02-2025, me objekt: Loti 2 Blerje bateri për automjete”, protokolluar me tonën me nr. 1879/2 prot, datë 23.07.2025, si dhe shkresës nr. 1393/18 prot, datë 22.07.2025, me objekt “Mbi shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik Alked Kopaçi PF lidhur me vlerësimin në procedurën e prokurimit me nr REF-46805-05-02-2025, me objekt: Loti 2 Blerje bateri për automjete”, protokolluar me tonën me nr. 1879/3 prot, datë 24.07.2025 ardhur nëpërmjetë shërbimit postar, rezulton se autoriteti kontraktor ka dërguar aktin e trajtimit të

ankesës nr. 72/2025, datë 22.07.2025 të operatorit ekonomik ankimues, ku konstatohet, se autoriteti kontraktor ka vendosur mospranimin e ankesës me argumentat si vijon:

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Alked Kopaçi” PF mbi skualifikimin e ofertes se OE “Kappa Oil” SHA, me arsyen se “[...] nuk ploteson piken 2.3.2 të Kriterëve të veçanta për kualifikim me pretendimin se nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi, KSHA verën se: “Në dokumentat e tenderit, Shtojca 8 “Formular i Kriterëve të Përzgjedhjes /Kualifikimit”, Pika 2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, nënpika 2.3.2 e kapacitetit teknik ishte përcaktuar: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar për mallrat e ofertuar (ku të provohet lidhja me prodhuesin) se është i autorizuar të tregtojë mallrat objekt prokurimi.

Në procesverbalin “Për Argumentimin dhe Miratimin e Specifikimeve Teknike dhe Kriterëve për Kualifikim” përcaktohet se: “Argumentimi: Kërkesa e mesipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar dhe nenin 40 pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet se, operatori ekonomik do të garantojë se malli i ofruar në rastin konkret është cilësor dhe sipas standarteve të kërkuara në dokumentet e tenderit. Në cdo rast operatori ekonomik gjatë periudhës së garancisë duhet të mbajë përgjegjësi për mallat që ofron dhe se do t’i përgjigjet autoritetit kontraktor në rast se malli i furnizuar demtohet gjatë përdorimit për shkak të defekteve që vijnë si rrjedhojë e prodhimit të tyre.

KSHA gjykon se autorizimi i prodhuesit duhet të jepet nga prodhuesi final që realizon prodhimin e produkteve objekt prokurimi. KSHA verifikoi dokumentacionin e paraqitur në SPE dhe dorezuar fizikisht nga operatori ekonomik i shpallur fitues paraprak dhe konkludon se është konform kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit, ndaj ky kriter konsiderohet i përmbushur. Gjithashtu KSHA, konstaton se autorizimi i prodhuesit i paraqitur nga operatori ekonomik ofertues, i shpallur fitues paraprak, “Kappa Oil” SHA, përmban të gjitha të dhënat e nevojshme të prodhuesit. Pra, dokumenti i paraqitur, autorizim prodhuesi është i plotë dhe përmban të gjitha të dhënat e nevojshme për të konsideruar të provuar lidhjen ndërmjet operatorit dhe prodhuesit. Në autorizim pasqyrohen qartë emri i plotë i operatorit që autorizohet, të dhënat identifikuese të prodhuesit (duke përfshirë adresën dhe logon zyrtare), si dhe përshkrimi i qartë i produktit/mallit për të cilat jepet autorizimi.

Për keto arsye, autorizimi i prodhuesit konsiderohet i vlefshëm dhe përmban të gjitha të dhënat që kerkohen për të garantuar transparencën, gjurmueshmërinë dhe besueshmërinë e marrëdhënies ndërmjet operatorit dhe prodhuesit.

Sa me sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

II.2. Lidhur me pretendimin e Operatorit Ekonomik “Alked Kopaçi” PF mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertes së OE “Kappa Oil” sha me pretendimin se: Operatori Ekonomik ofertues “Kappa Oil” SHA nuk ka

arritur te plotesoje piken 2.3.1 te kapacitetit teknik te shtojces 8, lidhur me paraqitjen e kontratave te meparshme te ngjashme te realizuara me sukses, KSHA arsyeton se: Ne dokumentet Standarte te tenderit “Kapaciteti teknik”, eshte percaktuar se: 2.3.1. Operatori ekonomik duhet te paraqese deshmi per furnizimet e meparshme te ngjashme të kryera gjate 3 (tre) viteve te fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates, ne vlerën jo më pak se 40 % e vleres së fondit limit te objektit që prokurohet. Keto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet te vertetohen me dokumentacionin si me poshte: a. Kur furnizimet e ngjashme jane realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqese vërtetimin e leshuar nga enti publik per permbushjen me sukses te kontrates dhe / ose faturat tatimore te shitjes te plotesuara sipas kerkesave të legjislacionit ne fuqi dhe te deklaruar ne organet tatimore, ku te shënohen datat, shumat dhe sasite e mallrave të furnizuara. b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqese faturen perkatese tatimore te shitjes te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi dhe të deklaruar ne organet tatimore, ku te shënohen datat, shumat dhe sasite e mallrave të furnizuara.

Ne ligjin nr. 162/2020 “Per Prokurimin Publik”, te ndryshuar, nenit 77 “Kerkesat per kualifikim”, pika 4 parashikohet se: “Ne lidhje me aftesite teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund te vendosin kerkesa qe garantone se operatoret ekonomike zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvorën e nevojshme per te zbatuar kontratën sipas nje standardi te pershtatshem cilesie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund te kerkojnë qe operatoret ekonomike te kene nje nivel te mjaftueshem përvore qe vertetohet nga referenca të pershtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën”. Referuar VKM Nr.285 date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar, Neni 40 “Kerkesa te vecanta per kontratat e mallrave”, pika 4, parashikohet shprehimisht se: “Per te provuar përvoren e meparshme, autoriteti/enti kontraktor kerkon deshmi per realizimin me sukses te nje ose disa kontratave te meparshme, të ngjashme, te kryera gjate tre viteve te fundit. Ne çdo rast, vlere totale e kerkuar duhet te jete ne nje vlere jo me të madhe se 40% te vleres se perlllogaritur te kontrates, qe prokurohet dhe qe eshte realizuar gjate tre viteve te fundit, nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates. Autoriteti/enti kontraktor si deshmi per përvoren e meparshme kerkon vertetime te leshuara nga nje ent publik per permbushjen me sukses te kontrates, ku te shenohen vlere, afati i perfundimit te kontrates ose/dhe fatura tatimore te shitjes, te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi, ku shenohen datat, shumat dhe sasite e mallrave te furnizuara. Ne rastin e përvores se meparshme te realizuar me sektorin privat, si deshmi pranohen vetem fatura tatimore te shitjes, te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi, dhe te deklaruar ne organet tatimore, ku shenohen datat, shumat dhe sasite e mallrave te furnizuara”.

Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave pasi verifikoi dokumentacionin e paraqitur ne sistemin e prokurimit elektronik nga OE “Kappa Oil” SHA ne kuader te permbushjes se kerkesës per deshmimin e kontratave te ngjashme te realizuara me sukses, konstaton permbushjen e kerkesës se percaktuar ne dokumentet e tenderit, sipas pikes operatori ekonomik duhet te paraqese deshmi per furnizimet e meparshme te ngjashme te kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates, ne vlerën jo me pak se 40% e vleres se fondit limit te objektit që prokurohet. Këto furnizime të mparshme, te ngjashme, duhet te vertetohen me

dokumentacionin si me poshte...”. Ky kriter konsiderohet i permbushur ne te treja aspektet e tij, konkretisht ngjashmerine ne natyre me objektin e procedures se prokurimit, vleren e perlllogaritur si dhe afatin kohor per kryerjen e këtyre furnizimeve gjate tre viteve te fundit. Ne kete kontekst, Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave e konsideron te permbushur kriterin e sipercituar dhe te sakte vleresimin e Komisionit te Vleresimit te Ofertave.

Per sa me siper, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qendron.

II.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Alked Kopaç” PF per shfuqizimin e vendimit te Komisionit te Vleresimit te Ofertave mbi kualifikimin e ofertes se OE “Kappa Oil” SHA lidhur me kataloget/skedat teknike, KSHA arsyeton se: Ne nenin 77 “Kerkesat per kualifikim” te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 “Për prokurimin publik” te ndryshuar percaktohet se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore percaktojne kerkesat per kualifikim per operatoret ekonomike bazuar në:

- a) pershtatshmerine per te kryer veprimtarine profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kerkesat kufizohen vetem ne ato qe janë të pershtatshme per te garantuar qe nje kandidat ose ofertues te kete kapacitetet juridike, financiare dhe aftesite teknike e profesionale per te zbatuar kontraten qe do te jepet. Te gjitha kerkesat duhet te kene lidhje dhe te jene proporcionale me objektin e kontrates.

2. Per sa i perket pershtatshmerise per te kryer nje veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund te kerkojne qe operatorët ekonomike te rregjistrohen ne nej nga rregjistrat profesionale ose tregtare.

Ne procedurat e prokurimit per sherbime, ku shtë e nevojshme qe operatorët ekonomike të kene nje autorizim te veçante ose te jene anëtare të nje organizate te veçante per te kryer sherbimin ne fjale ne shtetin e tyre te origjines, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kerkojë atyre te vertetojne se e kanë kete autorizim ose anëtaresim.

3. Ne lidhje me situatin ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kerkesa qe garantone se operatoret ekonomike kane kapacitetin e nevojshem ekonomik dhe financiar per te zbatuar kontraten.

Per këte qellim autoritetet ose entet kontraktore mund te kerkojne ne veçanti qe operatoret ekonomike te kene nje xhiro vjetore minimale te caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund te kerkojne qe operatorët ekonomike te japin informacione ne bilancet e tyre vjetore qe te tregone raportet ndermjet aktivitetit dhe pasivit.

Xhiroja vjetore minimale qe kerkohet nga operatoret ekonomike nuk mund te tejkalojte dyfishin e vleres se parashikuar te kontrates.

Kur nje kontrate ndahet ne lote, ky nen zbatohet per çdo lot individual. Megjithate, autoriteti ose enti kontraktor mund te percaktojte xhiron vjetore minimale qe u kerkohet operateve, duke iu referuar grupeve te loteve, ne rast se ofertuesi i suksesshem merr disa lote qe duhet te zbatohen ne te njejtën kohe.

Në rastin e kontratave qe bazohen ne nje marreveshje kuader, kerkesa per xhiron minimale logaritmet mbi bazën e permasave maksimale te kontratave specifike qe do te zbatohen në të njejtën kohe ose, kur permasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës se parashikuar te marreveshjes kuader.

4. Ne lidhje me aftesite teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund te vendosin kerkesa qe garantone se operatoret ekonomike zotërojnë burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe pervojen e nevojshme per te zbatuar kontraten sipas nje standardi te pershtatshem cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund te kerkojnë qe operatoret ekonomike të kene një nivel te mjaftueshëm pervoje qe vertetohet nga referenca te pershtatshme nga kontratat zbatuara në te shkuarën.

Aftesia profesionale e operateve ekonomike per te ofruar sherbimin, punën, mallin vleresohet ne lidhje me aftesite organizative, reputacionin dhe besueshmerine, pervojën e duhur, si dhe personelin e nevojshem per te zbatuar kontraten, sic eshte pershkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit te kontrates.

5. Autoritetet ose entet kontraktore percaktone ne njoftimin e kontrates ose ne ftesën per shprehje interesi kriteret e perzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete qe duhet te paraqesin operatorët ekonomike per permbushjen e ketyre kriterëve.

Ne nenin 40 “Kerkesa te veçanta per kontratat e mallrave”, pika 6, germa a) te VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, te ndryshuar percaktohet shprehimisht se: “Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kerkoje operateve ekonomike të dorezojne deshmi, qe tregojne se ata i plotesojne kerketat minimale, te percaktuara në dokumentet e tenderit, si: Mostra te mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndesi per vleresimin e ofertes teknike. Ne kete rast, autoriteti/enti kontraktor duhet te argumentojte kerketën per mostrat.

Mostrat duhet te trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet te jene në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Ne rastin e procedurave te zhvillara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor percakton qarte proceduren per dorezimin e mostrave, duke garantuar aksesin e cdo operatori te interesar si dhe konfidencialitetin per pjesemarrjen ne proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kerketën e tij, brenda 30 (tridhjetë) diteve pas nënshkrimit te

kontrates, me kusht qe kontrata ne fjalë te mos jete objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqesor.

Ne rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kerkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) diteve nga data e marrjes se vendimit perfundimtar te anulimit”.

Ne dokumentet standarte te tenderit, pika 2.3.2 e kapacitetit teknik, ishte percaktuar se: Operatori ekonomik te paraqese katalogë / broshurë / skede teknike te prodhuesit per artikujt objekt prokurimi ku te perfshihen specifikimet teknike te tyre. Operatori ekonomik duhet të markoj ne katalog / broshure / skede teknike (per lehtësi identifikimi) artikujt dhe specifikimet teknike sipas atyre te percaktuara në Shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve Teknike”, ne menyre qe të verifikohet perputhshmiria e tyre me dokumentet e tenderit. Dokumenti duhet te jete ne gjuhen shipe ose ate angleze.

Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave pasi verifikoi dokumentacionin e paraqitur ne sistemin e prokurimit elektronik, konstaton se ne permbushje te kriterit te sipercituar, operatori ekonomik ka paraqitur dokumentet me emertesat: “CATALOGUE HEAVY DUTTY ALB 3 2025”, “CATALOGUE AGM_ ALB_2025”, “CATALOGUE _MOTO_ ALB_2025”, “CATALOGUE N ATO_ ALB_2025”, “CATALOGUE Passenger-Cars_ ALB_2025” “CATALOGUE_START_STOP_ ALB_2025”. Nga shqyrtimi i tij rezulton se dokumentacioni i Nga shqyrtimi i dokumentacionit te paraqitur ne SPE, Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave konstaton se ne permbushje te specifikimeve teknike te percaktuar në Shtojcën 6 të Dokumenteve te Tenderit, operatori ekonomik “Kappa Oil” SHA ka paraqitur kataloget perkates, te cilet rezultojne konform specifikimeve teknike respektive per secilin artikull. Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave konstaton se kataloget e paraqitur nga ky operator ekonomik jane te qarte, te detajuar dhe permbajne te gjithë informacionin teknik te nevojshem, duke perfshire pershkrimin e plote te produkteve, karakteristikat teknike funksionale dhe fizike si dhe standardet e prodhimit dhe perputhshmerine me normat perkatese te cilesise dhe sigurise.

Per me teper, për çdo produkt te ofruar jane cituar qarte specifikimet qe korrespondone me ato te kerkuara sipas dokumenteve te tenderit, duke mundësuar nje verifikim te dretperdrejte dhe te paanshem te perputhshmerise teknike.

Bazuar ne sa me siper, rezulton se katalogët jane paraqitur ne menyre te rregullt, te dokumentuar dhe konform specifikimeve teknike te kerkuara, dhe si te tille, perbejne deshmi te vlefshme per vlerësimin teknik te ofertes dhe kualifikimin e saj.

Per sa me siper, pretendimi ankimuesit nuk qëndron.

II.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Alked Kopaçi” PF per shfuqizimin e vendimit te Komisionit te Vleresimit te Ofertave mbi:

- Rishikimin e procesit te vlerësimit te ofertave dhe verifikimin me perpikmeri te*

dokumentacionit te paraqitur nga operatorët ekonomike per autorizimet, katalogët teknikë dhe kontratat e ngjashme.

Skualifikimin e cdo operatori ekonomik qe nuk ka permbushur kriteret e detyrueshme, perfshire mungesën e autorizimit te prodhuesit ose mungesën/pasaktesine e katalogëve.

Zbatimin e parimit te barazise dhe transparences, si dhe te garantohet integriteti i procedures ne perputhje me Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe aktet nenligjore ne zbatim te tij.

Se pari, Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, thekson se referuar nenit 75 dhe nenit 96 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, te ndryshuar, eshte i percaktuar qartazi roli, detyrat, kompetencat dhe pergjegjesite e Komisionit te Vleresimit të Ofertave dhe Komisionit apo zyrtarit te ngarkuar per shqyrtimin e ankesave. Komisioni i Vleresimit te Ofertave ka per detyre te vleresoje ofertat fillestare te paraqitura nga operatoret ekonomike pjesemarres ne nje procedure prokurimi, ne perputhje me kriteret e paracaktuara ne dokumentet e tenderit dhe merr vendime lidhur me perzgjedhjen e fituesit. Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave vepron ne nje moment tjeter procedural, ushtron nje funksion te natyres administrative dhe juridike, duke shqyrtuar pretendimet per shkelje procedurale apo per trajtim te pabarabarte dhe te pasakte te operatoreve ekonomike pjesemarres ne nje procedure prokurimi.

Pra, Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave nuk mund te ushtroje rolin e Komisionit të Vleresimit te Ofertave, sepse kane funksione te ndara ne kohe, ne permbajje dhe ne kompetenca. Perzierja e ketyre roleve cenon integritetin e procedures, cenon te drejten e ankimit te drejte dhe objektiv, dhe bie ne kundërshtim me parimet baze te prokurimit publik. Ne kete kontekst, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues per nje rivleresim te te gjithë ofertave te paraqitura, eshte i pabazuar ligjesisht dhe shtrues ne zbatimin praktik.

Gjithashtu, referuar nenit 111 “Paraqitja e ankeses”, pika 2 e ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku citohet:

2. Ankesa behet sipas formularit perkates, ku shenohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi per proceduren konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon per shkeljet, pagesa e tarifës se ankeses, duke e shoqeruar ate me dokumentacionin dhe provat perkatese, per te cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e siperpermendura jane te domosdoshme per shqyrtimin e ankeses. Ankimesi ishte i detyruar t'i bashkëlidhe ankimit dokumentin bankar qe verteton pagesen e tarifës perkatëse per ankesen”.

Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave gjykon se për te mbështetur pretendimet e tij, ankimesi duhej te kishte shoqeruar ankesën e tij me prova, indice dhe argumenta ose dokumentacionin perkates, ne baze te te cilave do te shqyrtohej kjo ankese. Operatori ekonomik ankimes ka

detyrimin qe ta beje te identifikueshem pretendimin e tij mbi shkellen e pretenduar, pra te evidentojte qarte dhe sakte se ku e bazon pretendimin e tij per mospermbushjen e kriterit/kritereve nga ana e operatoreve ekonomike te tjere.

KSHA gjykon se ishte ne drejte te operatorëve ekonomike te paraqesin pretendime mbi kundershkrimin e vendimit te autoritetit kontraktor per kualifikimin e ofertes se operatorëve te tjere ekonomike pjesemarres ne proceduren e prokurimit, duke justifikuar keshtu interesin e tyre te ligjshem, por nderkohë, operatorët ekonomike ankimues nuk mund te parashtrojne pretendime a-priori duke iu referuar kritereve te veçanta te kualifikimit, duke mos dhine asj® prove apo argument se ku mbeshitet pretendimet e tij. Vete Kodi i Procedurave Administrative ka parashikuar ne nenin 82 pika 1 te tij se “Ne procedurat administrative, te filluara me kerkese te pales qe inicion proceduren, barra e proves per faktet e pretenduara bie mbi kete pale, pavaresisht nga detyrimi i organit publik per të vëne në dispozicion te paleve provat e zoteruara prej saj”.

Nje ankim pa argumente te arsyeshme apo indice te qarta, mbi te gjithë apo nje pjese te elementëve perberes te ofertes se konkurrentit/konkurrenteve te kualifikuar, bazuar ne LPP dhe aktet nenligjore ne zbatim te tij, konsiderohet abuziv dhe cënon efikasitetin dhe shpejtesine e procedures së prokurimit publik dhe nuk do te merret ne shqyrtim nga KSHA.

Per sa me siper, keto pretendime nuk do te merren ne shqyrtim.

Per Keto Arsye

Bazuar ne nenin 114 ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Per prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 102 te VKM-së nr.285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i ngarkuar per shqyrtimin e ankesës,

Vendosi

- 1. Refuzimin e ankess se paraqitur nga operatori ekonomik “Alked Kopaçi” PF.*
- 2. Personi pergjegjes per prokurimin te njoftoje per vendimin e marre ankimuesin, brenda dites se neserme te punes nga marrja e ketij vendimi.*
- 3. Personi pergjegjes per prokurimin te njoftoje per vendimin e marre operatorët ekonomike te interesuar, brenda dites se neserme te punes nga marrja e ketij vendimi.*
- 4. Personi pergjegjes per prokurimin te njoftoje per vendimin e marre Komisionin e Prokurimit Publik, brenda dites se neserme te punes nga marrja e ketij vendimi, duke e shoqeruar me shpjegimet dhe dokumentacionin perkates.*
- 5. Ky vendim i njoftohet menjehere Titullarit te Organit Qëndror Bleres.*

II.9. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113, ligji Nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “*Alked Kopaçi*” PF, mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e operatorit ekonomik “*Kappa Oil*” SHA në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me argumentin se nuk përmbush kriterin “*Mungesa e autorizimit të prodhuesit sipas dokumenteve të procedurës dhe në përputhje me nenin 61 të ligjit për dokumentacionin e kualifikimit teknik, kërkohet që OE të provojë aftësinë teknike për ofrimin e mallrave. Në këtë procedurë, kemi bindjen, duke marrë shkas nga procedura të mëparshme, se operatori ekonomik “Kappa Oil” nuk ka paraqitur këtë autorizim, ose kanë paraqitur një autorizim të vjetër, me referencë të një procedure të mëparshme për një autoritet kontraktor tjetër. Kjo është në kundërshtim të plotë me kërkesat e dokumenteve standarde të tenderit dhe rregullave të prokurimit publik. Mungesa e autorizimit të prodhuesit përbën shkak për skualifikim pasi nuk provohet lidhja e drejtpërdrejtë ose autorizimi për të tregtuar markat specifike. Pranimi i ofertave pa këtë dokument përbën një shkelje të parimit të barazisë ndërmjet operatorëve ekonomikë, si dhe cenon ligjshmërinë e vlerësimit të ofertave*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8/2 “*Kriteret e veçanta të kualifikimit*”, pika 2.3.3 “*Kapaciteti teknik*” Loti 2 e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim/ nje dokument nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar për mallrat e ofertuar (ku të provohet lidhja me prodhuesin) se eshte i autorizuar te tregtoje mallrat objekt prokurimi.

III.1.2. Në përmbushje të kriterit të më sipër cituar, operatori ekonomik “*Kappa Oil*” SHA ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik SPE dokumentacionin si më poshtë:

Autorizim cilit do që i intereson, për operatorin e blerjeve të përqendruara Tiranë Shqipëri. YIGIT AKU MALZ.NAK.SAN.VE.TIC.A.S që ndodhet në organizë Sanayi Bolgesi Oguz Caddasi No: 2 Sinacan/Ankara, Turkey, Nipt N. 9800034685 në cilësinë e prodhuesit dhe tregtuesit të baterive autorizon “Kappa Oil” SHA, Autostrada Dr – Tr, km 6, 2007 Durrës, Albania, Tel +35552264403, Fax +35552264402, email: info@kapaoil.com.al. Të marrë pjesë në tenderin me nr. Ref-46807-05-02-2025, loti 2 “Blerje bateri” me produktet tona. Ne i japin

të drejta të plota Kappa Oil SHA që të ofrojë, negocjojë dhe eventuaisht të nënshkruajë kontratë me ju për produktet tona.

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.1.4. Neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.5. Në nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.1.6. Në nenin 40, pika 6, germa a) të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentoj kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit;” dhe/ose

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

III.1.7. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin

e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.1.8. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, vërejmë se autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit, ka kërkuar që operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim/ nje dokument nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar për mallrat e ofertuar (ku të provohet lidhja me prodhuesin) se është i autorizuar të tregtojë mallrat objekt prokurimi. Për artikujt objekt prokurimi, bateri për automjete, operatori ekonomik ankimues ka deklaruar prodhues *YIGIT AKU MALZ.NAK.SAN.VE.TIC.A.S*. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, nga operatori ekonomik “*Kappa Oil*” SHA, KPP konstaton, se ky i fundit në përmbushje të kriterit 2.3.3, ka paraqitur dokumentacionin e përmendur në pikën III.1.2. të këtij vendimi. Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se, me autorizimin e lëshuar nga *YIGIT AKU MALZ.NAK.SAN.VE.TIC.A.S*, deklarohet që në këtë autorizim shfaqet si prodhues kryesor për bateri automjete. Në përmbajtje të kësaj deklarate janë të përfshira detajet e kërkuara nga autoriteti kontraktor, nr. kontakti, adresë emaili etj, në përmbushje të kriterit të kërkuar nga autoriteti kontraktor. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së këtij dokumenti eme emërtim “Autorizim prodhues”, ku si prodhues kryesor për baterit e automjeteve, *YIGIT AKU MALZ.NAK.SAN.VE.TIC.A.S* ka lëshuar autorizimin për operatorin ekonomik, “*Kappa Oil*” SHA, për procedurën e prokurimit objekt ankimi, ku si prodhues do të furnizojë dhe dorëzojë mallra në bazë të referencës së prokurimit me objekt: *loti 2 “Blerje bateri” me Ref-46807-05-02-2025, me produktet tona. Ne i japin të drejta të plota Kappa Oil SHA që të ofrojë, negocojë dhe eventuaisht të nënshkruajë kontratë me ju për produktet tona*”.

Synimi i kërkesës së autoritetit kontraktor për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose autorizimit nga distributori zyrtar i autorizuar për mallrat objekt-prokurimi është garantimi që ofertuesi ka aftësi të mjaftueshme për të realizuar me sukses dhe cilësi kontratën me autoritetin kontraktor, duke furnizuar brenda kohës së përcaktuar mallra objekt-prokurimi, pra autorizimi nga prodhuesi është një dokument nëpërmjet të cilit autoriteti kontraktor sigurohet që

subjekti/shoqëria që lëshon këtë dokument, autorizon operatorin ekonomik që t'a furnizojë me produktet e tij duke siguruar garancinë e mallit, gjë e cila nuk garantohet me modelin e ofruar.

Nisur nga pretendimet e ankimuesit si dhe nga dokumentacioni i dorëzuar nga operatori ekonomik "Kappa Oil" SHA, në përmbushje të pikës 2.3.3, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se me dokumentacionin e paraqitur, operatori ekonomik "Kappa Oil" SHPK arrin të provojë përmbushjen e kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.3 të dokumenteve të tenderit. KPP, gjykon se me dokumentacionin e paraqitur ky operator ekonomik e përmbush kriterin e përcaktuar në pika 2.3.3 "Kapaciteti teknik", të dokumentave të tenderit të procedurës objekt shqyrtimi. Pra, referuar dokumentacionit të mësipërm, konstatohet se dokumenti "Autorizim" me përmbajtje "Cilit do që i intereson, për operatorin e blerjeve të përqendruara Tiranë Shqipëri. YIGIT AKU MALZ.NAK.SAN.VE.TIC.A.S që ndodhet në organizë Sanayi Bolgesi Oguz Caddasi No: 2 Sinacan/Ankara, Turkey, Nipt N. 9800034685 në cilësinë e prodhuesit dhe tregtuesit të baterive autorizon "Kappa Oil" SHA, Autostrada Dr – Tr, km 6, 2007 Durrës, Albania, Tel +35552264403, Fax +35552264402, email: info@kapaoil.com.al. Të marrë pjesë në tenderin me nr. Ref-46807-05-02-2025, loti 2 "Blerje bateri" me produktet tona. Ne i japin të drejta të plota Kappa Oil SHA që të ofrojë, negocjojë dhe eventuaisht të nënshkruajë kontratë me ju për produktet tona", rezulton se është i vlefshëm dhe në përputhje me deklaratimet e bëra nga ana e operatorit ekonomik në shtojcën 2 "Lista e Çmimeve të Artikujve". Akoma më tej vlen të theksojmë se, autoriteti kontraktor disponon të gjitha elementet e nevojshme procedurale, si garanci, në rast të shkeljes së kontratës, konkretisht neni 83 "Sigurimi i ofertës" i Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar si dhe neni 36 "Sigurimi i kontratës", të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se në bazë të nenit 124 "Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës" të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe nenit 107 "Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje se, referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t'u siguruar nëse cilësia e mallit apo shërbimit do të jetë e njëjtë me cilësinë dhe specifikimet teknike të premtuara në ofertë dhe të përcaktuara në kontratë. Në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, autoriteti kontraktor zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë, apo detyrimet, në mbështetje të ligjit dhe rregullave për prokurimin publik, si më sipër cituar. Pra, operatori ekonomik "Kappa Oil" SHA, me dokumentacionin e paraqitur, plotëson kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit, në lidhje me autorizimin e prodhuesit.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues "Alked Kopaçi" PF nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "Alked Kopaçi" PF, për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik "Kappa Oil" SHA me arsyen se: "Mospërmbushja e vlerës së kontratave të ngjashme kriter ekonomik gjithashtu mendojmë dhe kërkojmë nga ana juaj verifikimin e kontratave të ngjashme të paraqitura nga OE "Kappa

Oil”, nëse ato i përkasin realisht objektit të procedurës (blerje baterish), nëse përputhen me vlerën dhe karakteristikat teknike të kërkuara”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 8/2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” pika 2.3.1 “Kapaciteti teknik”, loti II të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të objektit që prokurohet. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe / ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.
- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

III.2.2. Në shtojcën 8/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, loti 2. “Kapaciteti Teknik”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kërkesa si më poshtë:

Shënim: Operatori ekonomik i cili oferton në më shumë se sa një Lot, duhet të ketë/disponojë kapacitetin ekonomik – financiar (pika 2.2.1 e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetin teknik pika 2.3.1 e seksionit 2.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku.

III.2.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik “Kappa Oil” SHA në përmbushje të kriterit dhe të kërkesës më sipër ka dorëzuar faturat si më poshtë:

Nr. 25563, datë 24.11.2022; Nr. 25459, datë 18.11.2022; Nr. 25362, datë 14.11.2022; Nr. 25277, datë 09.11.2022; Nr. 25566, datë 24.11.2022; Nr. 24663, datë 07.10.2022; Nr. 43072, datë 29.12.2022; Nr. 26102, datë 20.12.2022; Nr. 24528, datë 30.09.2022; Nr. 26252, datë 27.12.2022; Nr. 25880, datë 07.12.2022; Nr. 24542, datë 31.10.2023; Nr. 24470, datë 27.10.2023; Nr. 24663, datë 06.11.2023; Nr. 10599, datë 01.02.2023; Nr. 10, datë 04.01.2023; Nr. 23368, datë 11.09.2023; Nr. 1114855, datë 28.07.2023; Nr. 21378, datë 05.06.2023; Nr. 11448, datë 16.03.2023; Nr. 23123, datë 29.08.2023; Nr. 20712, datë 06.05.2023; Nr. 11044, datë 23.02.2023; Nr. 24162, datë 16.10.2023; Nr. 23477, datë 16.09.2023; Nr. 23254, datë 05.09.2023; Nr. 22459, datë 27.07.2023; Nr. 21703, datë 21.06.2023; Nr. 21673, datë 20.06.2023; Nr. 20989, datë 20.05.2023; Nr. 11136711, datë 21.10.2023; Nr.

24706, datë 07.11.2023; Nr. 10092, datë 07.01.2023; Nr. 1113975, datë 14.04.2023; Nr. 25741, datë 20.12.2023; Nr. 1114220, datë 15.05.2023; Nr. 20347, datë 17.04.2023; Nr. 24382, datë 25.10.2023; Nr. 22335, datë 21.07.2023; Nr. 11137382, datë 26.12.2023; Nr. 23087, datë 28.08.2023; Nr. 21093, datë 24.05.2023; Nr. 25178, datë 27.11.2023; Nr. 11311, datë 09.03.2023; Nr. 20300, datë 15.04.2023; Nr. 113, datë 16.01.2023; Nr. 22226, datë 15.07.2023; Nr. 21172, datë 27.05.2023; Nr. 25727, datë 19.12.2023; Nr. 23819, datë 02.10.2023; Nr. 20367, datë 18.04.2023; Nr. 24473, datë 28.10.2023; Nr. 21695, datë 21.06.2023; Nr. 25445, datë 07.12.2023; Nr. 25304, datë 30.11.2023; Nr. 10393, datë 25.01.2024; Nr. 11212, datë 05.03.2024; Nr. 11691, datë 29.03.2024; Nr. 870, datë 03.04.2024; Nr. 12376, datë 08.05.2024; Nr. 12619, datë 21.05.2024; Nr. 14284, datë 22.08.2024; Nr. 14389, datë 27.08.2024; Nr. 15827, datë 06.11.2024; Nr. 10061, datë 08.01.2024; Nr. 10926, datë 19.02.2024; Nr. 13077, datë 12.06.2024; Nr. 13379, datë 28.06.2024; Nr. 13460, datë 02.07.2024; Nr. 14647, datë 10.09.2024; Nr. 2970, datë 25.11.2024; Nr. 12744, datë 28.05.2024; Nr. 2741, datë 31.10.2024; Nr. 15897, datë 09.11.2024; Nr. 3222, datë 23.12.2024; Nr. 12754, datë 28.05.2024; Nr. 16132, datë 20.11.2024; Nr. 1334, datë 24.05.2024; Nr. 3093, datë 10.12.2024; Nr. 416, datë 13.02.2024; Nr. 11079, datë 27.02.2024; Nr. 1166, datë 08.05.2024; Nr. 2558, datë 10.10.2024; Nr. 2648, datë 22.10.2024; Nr. 16749, datë 19.12.2024; Nr. 15508, datë 22.10.2024; Nr. 16071, datë 16.11.2024; Nr. 13819, datë 22.07.2024; Nr. 13466, datë 02.07.2024; Nr. 15839, datë 07.11.2024; Nr. 11069, datë 26.02.2024; Nr. 11734, datë 01.04.2024; Nr. 14712, datë 12.09.2024; Nr. 15300, datë 14.10.2024; Nr. 2754, datë 01.11.2024; Nr. 3214, datë 23.12.2024; Nr. 14490, datë 24.04.2025.

III.2.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

III.2.4. Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.2.5. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”

III.2.6. Neni 39 “Ndarja e kontratave në lote”, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të japë një kontratë në formën e loteve të veçanta, duke përcaktuar madhësinë dhe objektin e këtyre loteve.

Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.

2. Autoriteti ose enti kontraktor përcakton në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi ose kur thirrja për konkurrim bëhet përmes njoftimit për ekzistencën e një sistemi kualifikimi, në ftesën për ofertë ose për të negociuar, nëse ofertat mund të dorëzohen për një, për disa ose për të gjitha lotet.

Edhe kur ofertat mund të dorëzohen për disa ose të gjitha lotet, autoriteti ose enti kontraktor mund të kufizojë numrin e loteve që mund t'i jepen një ofertuesi, nëse numri maksimal i loteve për ofertues deklarohet në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi, në ftesën për ofertë ose në ftesën për të negociuar.

Kur zbatimi i kriterëve për shpalljen e kontratës fituese do të bënte që një ofertues të shpallej fitues i më shumë loteve sesa numri maksimal, autoriteti ose enti kontraktor përcakton në dokumentet e tenderit kriteret objektive dhe jodiskriminuese ose rregullat që synojnë të zbatojnë për të përcaktuar lotet që do të jepen.

3. Kur të njëjtit ofertues mund t'i jepet më shumë se një lot, autoriteti ose enti kontraktor mund të japë kontrata që kombinojnë disa ose të gjitha lotet, pasi të kenë specifikuar në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi mundësinë për ta bërë këtë, dhe lotet ose grupet e loteve që mund të kombinohen.

III.2.7. Në nenin 40 pika 4 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasisht e mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasisht e mallrave të furnizuara.

III.2.8. Në nenin 42 “Kontrata për punë/mall/shërbim e ndarë në lote” të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.

2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.

3. Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.

4. Autoriteti/enti kontraktor përcakton në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi ose, kur thirrja për konkurrim bëhet përmes njoftimit për ekzistencën e një sistemi kualifikimi,

në ftesën për ofertë ose për të negociuar, nëse ofertat mund të dorëzohen për një, për disa, ose për të gjitha lotet.

5. Autoriteti/enti kontraktor mund të kufizojë numrin e loteve që mund t'i jepen një ofertuesi, me kusht që numri maksimal i loteve për ofertues të deklarohet në njoftimin e kontratës, në ftesën përshprehje interesi, në ftesën për ofertë ose në ftesën për të negociuar.

6. Kur zbatimi i kriterëve për shpalljen e kontratës fituese do të bënte që një ofertues të shpallej fitues i më shumë loteve se sa numri maksimal, autoriteti/enti kontraktor përcakton në dokumentet e tenderit kriteret objektive dhe jodiskriminuese ose rregullat që synojnë të zbatojnë për të përcaktuar lotet që do të jepen. Këto kriterë duhet të jenë në përputhje me LPP-në dhe me ato të përcaktuara në nenin 91 të këtyre rregullave.

7. Kur të njëjtit ofertues mund t'i jepet më shumë se një lot, autoriteti/enti kontraktor mund të japë kontrata që kombinojnë disa ose të gjitha lotet, vetëm nëse ka specifikuar më parë, në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi, mundësinë për ta bërë këtë, dhe lotet ose grupet e loteve që mund të kombinohen.

8. Autoriteti/enti kontraktor mund të përcaktojë kërkesat minimale që u kërkohen operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

9. Në çdo rast, lotet janë të organizuara si procedura të veçanta brenda një procedure. Fillimi dhe përfundimi i njërit lot nuk ndikon në lotin tjetër të procedurës.

III.2.9 . Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit

me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues, i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.2.10. Komisionit të Prokurimit Publik pas shqyrtimit në tërësi të dokumentacionit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi rezulton, se procedura në fjalë është procedurë e ndarë në lote. Gjithashtu nga verifikimi i loteve të publikuara në sistemin e prokurimeve elektronike si dhe databazës së regjistrit të ankesave rezulton, se operatori ekonomik “Kappa Oil” SHA rezulton pjesëmarrës (ofertues) në Lotin II dhe në Lotin III, njëkohësisht ankimues për lotin III dhe subjekt i inetersuar për lotin II. Nga ky verifikim Komisioni arrin në konkluzion, se operatori ekonomik “Kappa Oil” SHA është ofertues në dy lote dhe në lotin II dhe në lotin III, ku për lotin III ka qënë i skualifikuar dhe ankimues, por pas pranimit të ankesës nga ana e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës pranë autoritetit kontraktor ky operatorë ekonomik është kualifikuar dhe nga ana e KPP-së është mbyllur çështja, ndërsa në lotin II rezulton i kualifikuar dhe subjekt i interesuar. Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga ankimuesi në sistemin e prokurimeve elektronike, si dhe pretendimeve të ankimuesit rezulton se operatori ekonomik ankimues “Kappa Oil” SHA ka ofertuar dhe dorëzuar si dokumenatcion në përmbushje të kriterit dhe kërkesës më sipër të autoritetit kontraktor faturat e cituara në pikën III.2.3. të këtij vendimi ku rezulton se vlera në total e tyre është **19,336,872 lekë pa TVSH**. Autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit pika 2.3.1 e kriterëve të veçanta të kualifikimit për lotin II dhe lotin III ka përcaktuar që operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të objektit që prokurohet, ku fondi limit për lotin II është **39,522,590.84 lekë pa TVSH** dhe fondi limit për lotin III është **83,967,400 lekë pa TVSH**. Nga ana tjetër gjithashtu ka kërkuar që: **“Shënim: Operatori ekonomik i cili oferton në më shumë se sa një Lot, duhet të ketë/disponojë kapacitetin ekonomik – financiar (pika 2.2.1 e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetin teknik pika 2.3.1 e seksionit 2.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku”**. Referuar hartimit të kriterit të vecantë të kualifikimit të përcaktuar në pikën 2.3.1 për kontratat e ngjashme dhe vlerës së kërkuar për lotet ku ofertuesi “Kappa Oil” SHA ka paraqitur ofertën e tij (për lotin II vlera e kerkuar eshte jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit, ku fondi limit për lotin II është **39,522,590.84 lekë pa TVSH**, dhe për lotin III vlera e kerkuar eshte jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit, ku fondi limit për lotin III është **83,967,400 lekë pa TVSH**), si dhe kërkesës së autoritetit kontraktor që operatorët ekonomikë të cilët do të paraqesin ofertat/konkurrojnë për më shumë se nje lot, duhet të plotesojnë pervojen e ngjashme sipas pikes 2.3.1. si shumë të loteve për të cilat konkurojnë, vlera e faturave të paraqitura nga ankimuesi për lotin II objekt ankimi si dëshmi e shërbimeve të ngjashme të kryera brenda tre viteve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës duhet të jo më pak se 40% e shumatorës së vlerës së kontratave të ngjashme të kërkuar për lotin II dhe për lotin III ku ankimuesi është ofertues, të marra së bashku, pra jo më pak se **49,395,996 lekë pa TVSH**. Ndërkohë nga verifikimi i vlerës së faturave të paraqitura nga operatori ekonomik “Kappa Oil” SHA në SPE

për lotin II në përmbushje të kriterit të veçantë të kualifikimit të përcaktuar në pikën 2.3.1 është **19,336,872** lekë pa TVSH, ndërkohë që në respektim të kërkesës së autoritetit kontraktor duhet të ishte në vlerën **49,395,996** lekë pa TVSH.

Referuar sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik vëren, se autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë që **“Operatori ekonomik i cili oferton në më shumë se sa një Lot, duhet të ketë/disponojë kapacitetin ekonomik – financiar (pika 2.2.1 e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetin teknik pika 2.3.1 e seksionit 2.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku”**. KPP vëren, se ankimesi ka paraqitur dokumentacionin fatura të ngjashme për vërtetueshmërinë e furnizimeve të ngjashme në total në vlerën **19,336,872** lekë pa TVSH, ndërkohë që autoriteti në dokumentat standarte të tenderit ka përcaktuar se nëse operatori ekonomik oferton në më shumë se një lot duhet të disponojë kapacitetin teknik të furnizimeve të ngjashme sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar pra ky operator ekonomik duhet të vërtetonte se dispononte furnizime të ngjashme në vlerën **49,395,996** lekë pa TVSH. Kështu, në nenin 77 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet se: “Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës”. Ndërsa në nenin 42 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Autoriteti/enti kontraktor mund të përcaktojë kërkesat minimale që u kërkojnë operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë”. Kështu, ligjvënësi ka parashikuar se kërkesat e vendosura në dokumentet e procedurës së prokurimit duhet të jenë në proporcion me objektin e kontratës. Nga ana tjetër, vetë autoriteti kontraktor në arsyetimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit në lidhje me këtë kriter ka përcaktuar se **operatori ekonomik i cili oferton në më shumë se sa një Lot, duhet të ketë/disponojë kapacitetin ekonomik – financiar (pika 2.2.1 e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetin teknik pika 2.3.1 e seksionit 2.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku”**. Në rastin konkret, si dhe nga verifikimi i kryer rezulton, se operatori ekonomik “Kappa Oil” SHA ka ofertuar në dy lote, edhe në lotin II edhe në lotin III, rrjedhimisht në lidhje me plotësimin e kriterit për kontratat të ngjashme duhet të plotësonte vlerën e shumatorës së dy loteve së bashku. Në këtë kuptim KPP gjykon, se operatori ekonomik “Kappa Oil” SHA është në kushtet e mospërmbushjes së kërkesave në kriterin e veçante të kualifikimit të përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi, sa i takon përmbushjes së kriterit të nënpikave 2.3.1 **sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku**. KPP gjykon, gjykon, se është barrë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, të vërtetojë se disponon kapacitetet tekniko-ligjore në lidhje me licencat e kërkuara. Gjithashtu, bazuar edhe në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, barra e provës për të vërtetuar plotësimin e kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, bie mbi operatorin ekonomik, i cili në rastin konkret ka dështuar ta vërtetojë atë. Referuar mangësive të konstatuara në dokumentacion nuk arrihet të vërtetohet disponimi i fatkurave të ngjashme **sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku, pra e lotit II dhe lotit III**. Për sa kohë që operatori ekonomik “Kappa Oil” SHA është

ofertues në dy lote atëherë për përmbushjen e këtij kriteri duhet të paraqiste dokumentacion sa shumatorja e të dy loteve, në përputhje me të dhënat e kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

III.2.11. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se nga ana e operatorit ekonomik “Kappa Oil” SHA nuk janë përmbushur të gjitha kërkesat që autoriteti kontraktor ka përcaktuar në këto dokumente, pasi ky operator ekonomik ka qenë i detyruar të plotësojë çdo kërkesë dhe kriter të vendosur nga autoriteti kontraktor dhe të paraqesë çdo dokumentacion që përmban të dhëna dhe elemente që janë gjykuar të nevojshme dhe të domosdoshme nga ana e këtij të fundit. Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik “Kappa Oil” SHA nuk plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit, pasi nuk ka ofertuar sipas përcaktimeve të bëra në dokumentet e tenderit. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kriteret kualifikuese dhe kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe legjislacionin në fuqi. KPP gjykon, se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Bazuar në nenin 1 dhe nenin 2 të LPP, në të cilët përcaktohet përkatësisht: “Qëllimi i këtij ligji është: [...] të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik”; “Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me parimin: a) Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale”, KPP gjykon, se operatori ekonomik “Kappa Oil” SHA duhet të kishte dorëzuar fatura të ngjashme sipas kërkesave të autoritetit kontraktor në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi ku është cituar se **Operatori ekonomik i cili oferton në më shumë se sa një Lot, duhet të ketë/disponojë kapacitetin ekonomik – financiar (pika 2.2.1 e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetin teknik pika 2.3.1 e seksionit 2.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku**”.

III.2.12. Gjithashtu, kuadri ligjor, parashikon një sërë elementësh, si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori

ekonomik “Kappa Oil” SHA do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 75 i LPP-së. Në nenin 75, pika 1 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se “[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit [...]”. Komisioni gjykon, se është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me kriteret dhe kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, për sa kohë që i kanë pranuar ato dhe nuk i kanë bërë në asnjë rast objekt-ankimimi.

Për sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Alked Kopaçi” PF qëndrojnë.

III.3. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “Alked Kopaçi” PF mbi kualifikimin e shoqërisë “Kappa Oil” SHA., Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se nuk do të merren në shqyrtim pasi, referuar gjykimit mësipër në pikën III.2, gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “Kappa Oil” SHA do të ndryshojë duke u skualifikuar nga procedura në fjalë, e rrjedhimisht duke përmbushur interesin e ankimuesit.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Alked Kopaçi” PF për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-46805-05-02-2025, me objekt: Loti 2 “Blerje bateri për automjete”, me fond limit 39,522,590.84 (tridhjetë e nëntë milionë e pesëqind e njëzet e dy mijë e pesëqind e nëntëdhjetë pikë tetëdhjetë e katër) lekë pa TVSH dhe 401,203.85 (katërqind e një mijë

e dyqind e tre) euro pa TVSH, zhvilluar më datë 04.06.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

2. Autoriteti kontraktor të skualifikojë operatorin ekonomik “Kappa Oil” SHA, sipas konstatimeve të këtij vendimi.
 3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “*Alked Kopaçi*” PF.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi, i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

